



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË



NOTER HELIAN V. ZENELAJ
ADRESA KONT URANI, NR.3
TEL: 674010730

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 4038

Nr. koleksioni: 1027

Tirane më 02/10/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2023053050122760564



A2023053050121740619

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE

DEGA VENDORE TIRANË
NOTER HELIAN V. ZENELAJ

Nr. 4038 Rep. Nr. 1027 Kol.



KONTRATË SHITJE
TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË
Semplice Albania SHPK

Sot, më datë 02/10/2023 (dymije e njezete e tre) para meje Noter HELIAN V. ZENELAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tirane, me zyrë në adresën Tirane, rr “Kont Urani”, NR.3, u paraqiten personalisht:

SHITES: Z. Gramoz Kryemadhi, shtetas italian, lindur më 14.07.1982, në Elbasan, banues në Via G.C.Abba, N.18 02 Reggio Nell’Emilia, mbajtës i leternjoftimit me Nr.CA55816PI, me zotesi te plote juridike per te vepruar,
(Ketu e meposhte referuar si “Shitesi”)

BLERES: Shoqeria SEMPLICE GAS E LUCE S.R.L., me NIPT Nr. 11796930011, me seli ne Via San Quintino N. 4 – 10121 Torino, përfaqësuar nga Kryetar i bordit të drejtorëve Z. Vincenzo Lilli, shtetas italian, lindur më 01.02.1968, në Montecchio, mbajtës i Pasaportës Nr. YA9463404, bazuar në Vendimin i Bordit te Drejtoreve date 01.09.2023. (Ketu e meposhte referuar si “Bleresi”)

Pala blerese nuk komunikon ne gjuhen Shqipe por e njej dhe komunikon ne gjuhen angleze, per kete arsye u thir prezente perkthyes Marilda Gjençaj, e bija e Gasper, mbajttese e Leternjoftimit me Nr. Personal H85526051G, madhore, e njohur nga Ministria e Drejtesise me nr. NIPT L91322006F.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 83, 705 e vijues i tij, ligjit nr. si dhe ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, neneve 62, 63, 105, 106, 108, 126, 127 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri hartimin e Kontratës së Shitjes se Kuotave, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE

Shitesi zotëron 100% të kapitalit që korrespondon në 1 kuote me një vlerë totale prej 10.000 Lekë të shoqërisë Semplice Albania SHPK, me NIPT Nr. M32030012I, (këtu e mëposhtë referuar si “Shoqëria”).

Neni 1
Objekti i Kontratës



A2023053050121740619

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate Shitësi i transferon Blerësit me anë të shitblerjes, kuotat e meposhtme:
- **Z. Gramoz Kryemadhi** transferon 100% të kapitalit te barabarte me 1 kuote me një vlerë te pergjithshme (vlere nominale dhe e shitjes) prej 10.000 Lekë tek **Shoqeria SEMPLICE GAS E LUCE S.R.L**
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë pjesët (kuotat) e kapitalit të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.
- 1.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Transferimi i pjesëve (kuotave) të kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate nga Shitësi tek Blerësi do te kryhet sipas menyres se meposhtme:
- **Shoqeria SEMPLICE GAS E LUCE S.R.L** do te paguaje shumen prej 10.000 Lekë ndaj **Z. Gramoz Kryemadhi**.
- 2.2 Palët deklarojnë së çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate është paguar tërësisht nga Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 3

Kalimi i Pronësisë

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me pjesen e tij ne kapital, përfshirë pjesëmarrjen në fitimet e Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë. Pas nenshkrimit te kesaj Kontrate, raportet e paleve ne shoqeri do te jene si me poshte:
- **Shoqeria SEMPLICE GAS E LUCE S.R.L** do te zoteroje 100% të kapitalit te barabarte me 1 kuote me një vlerë te pergjithshme prej 10.000 Lekë ;

Neni 4

Garancitë

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kapitali i shoqërisë objekt të kësaj kontrate, janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.2 Shitësi deklaron se Shoqëria ka depozituar dhe paguar rregullisht dhe në kohë të gjitha tatimet, taksat, pagesa të kontributit shoqëror, kontribute të çdo lloji, zbritje apo mbajtje të çdo tipi të aplikuar në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të ardhurat, fitimet, pasuritë neto,



A2023053050121740619

doganat, vlerës së shtuar apo çdo referencë tjetër, në nivel kombëtar apo lokal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5

Forca Madhore

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfaredolloj dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore ose rastit faktor dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësimë, ose akte të pushtetit qendror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

Neni 6

Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

Neni 7

Legjislacioni i zbatueshem

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreshjeve

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarreshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Pare Tiranë Shqipëri.

Neni 9

Shpenzimet

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit do të jenë në ngarkim të Palëve.



A2023053050121740619

Neni 10**Ndryshimet**

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

Neni 11**Hyrja ne fuqi**

- 11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

Neni 12**Gjuha e kontratës**

- 12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe dhe Italiane.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata u lexua nga unë Noteri me zë të lartë u perkthye nga perkthyes Marilda Gjençaj dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Taksa e pulles ne vleren 200 leke vendoset e aktin noterial qe mbahet ne arshive.

PALËT**SHITESI****Z.Gramoz Kryemadhi**

GRAMOZ KRYEMADHI

BLERESI**SEMPLICE GAS E LUCE S.R.L**

Perfaqesuar nga Z. Lilli Vincenzo

VINCENTO LILLI

PERKTHYESE :**Marilda Gjençaj**SEMPLICE GAS & LUCE SRL
Via San Quintino 4 - 10121 TORINO
C.F. e P. IVA 11796930011**NOTER****NOTER****MELIAN ZENELA**

C.F. e P. IVA 11796930011

